



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 733/1 Prot.

Tiranë, më 12 / 06 / 2020

V E N D I M

Nr. 61, Datë 12 / 06 / 2020

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 44, datë 03.06.2020, të H.D kundër Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë Epror¹, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash informon se, prej vitit 2010 e deri në datë 01.10.2019 ka qenë invalid i grupit I-rë. Në muajin Tetor 2019 është rikomisionuar dhe e kanë njoftuar që dokumentacionin e ka të rregullt dhe të plotë, ndërsa përgjigjen do ta merrte në KMCAE Dibër. KMCAE Epror në Tiranë, pas 3 muajve e ka njoftuar se ka mungesë dokumentacioni dhe dosja i ishte kthyer në KMCAE Dibër, pa grup të parë. Nga data 22.01.2020 deri në datë 23.01.2020 ka qenë i shtruar në Spitalin e Traumës, Tiranë.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe rivendosjen e trajtimit si invalid i grupit I-rë.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose*

¹ KMCAE Epror me Vendimin nr. 1733, datë 13.11.2019 ka vendosur se H.D nuk përfiton pagesën nga Ligji nr. 57/2019 “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 618, datë 07.09.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, ndryshuar me VKM nr. 813, datë 29.12.2017.

filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD, konstatohet se:

- Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Dibër me shkresën nr. 409, datë 18.09.2019, ka dërguar dokumentacionin e H.D, tek KMCAP-it Epror, në të cilën përshkruhet se: *“Personi është komisionuar në KMCAP Dibër me datë 03.09.2019 me nr. Vendimi 1518 dhe është vlerësuar, Grupi i parë. Një nga anëtarët e komisionit nuk është dakord me vendimin dhe kërkon që të rishqyrtohet”.*
- KMCAP Epror, me Vendimin nr. 1733, datë 13.11.2019 ka caktuar se, H.D është, pa grup, prej datës 01.10.2019 dhe nuk përfiton pagesën e aftësisë së kufizuar.

Lidhur me pretendimet e subjektit ankues, për kundërshtimin e vendimit të Komisionit Epror të Caktimit të Aftësisë për Punë, Komisioneri informon subjektin ankues, se vendimi i këtij Komisioni është i formës së prerë. Rimarrja në shqyrtim e vendimeve të këtij organi nuk bën pjesë në kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi².

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/ç, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili citon se: *“Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”*, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Neni 42 i Kushtetutës vendos standarde kushtetuese si për gjykatat, ashtu dhe për organet e administratës publike. Pika 2 e po këtij neni, sanksionon se kushdo mund t’i drejtohet gjykatës për të mbrojtur një të drejtë, liri apo interes kushtetues e ligjor. Kjo dispozitë, ndër të tjera, ka për

² Për analogji citojmë: Vendimin nr.185, datë 28.09.2018, Vendimin nr.55, datë 24.04.2019 dhe Vendimin nr.06, datë 08.01.2020 të KMD, publikuar në ëeb-in e institucionit: www.kmd.al

qëllim të garantojë shtetasit nga çdo veprim që u shkakton cënim të të drejtave të tyre, pa përjashtuar dhe rastin kur cënimi vjen dhe nga një akt administrativ i tillë.

Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 39/1 “Ankimimi në Komisionin Epror”, në pikën të 3 të tij, ka përcaktuar se: *“Vendimi i Komisionit Epror është i formës së prerë”*.

Në përfundim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ju rekomandon që bazuar në Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Ligjin 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar, t’i drejtoheni Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për të kundërshtuar vendimin e KMCAP Epror, i cili është i formës së prerë, por nuk është i formës përfundimtare.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i rekomandon subjektit ankues, që t’i drejtohet për ofrimin e ndihmës ligjore falas, Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike³, ose Shërbimit Ligjor Falas⁴.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç dhe 10 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës së shtetasit H.D, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONER

Robert GAJDA

³ Me adresë: Pranë Ministrisë së Drejtësisë, Blv. “Zogu i Parë”, Tiranë.

⁴ Me adresë: Blv. “Bajram Curri”, Pall: “Agimi”, Shk. 18, Ap. 322, Tiranë, Nr.tel: 0422 53113.